



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:144185

Datë: 26.06.2024

Numri i dokumentit: 05864673

P.nr.196/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me sekretaren juridike Fatmire Podvorica si procesmbajtëse dhe bashkëpunëtorin profesional Muhamet Musliu, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. H., për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2286/2024 të datës 12.06.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar publik, më datë 26.06.2024 në praninë e Prokurorit të Shtetit Ardiana Veseli, përfaqësuesit të dëmtuarës M. Zh. dhe të pandehurit, në të njëjtën ditë mori publikisht, shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

B. H., nga i ati M. dhe e ëma R., e gjinisë Rr. i lindur më datë ..., në M., me vendbanim në rr. "F.", ne P., ka të kryer shkollën fillore, i pa punësuar, i martuar baba i katër fëmijëve, i gjendjes se dobet ekonomike, me nr. Personal ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovë

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

Me datën 10.03.2024 ne ora 15:17, në venin e quajtur "Rr. e M." në rajonin ekonomike pyjor T., Komuna P., i pandehuri me qellim të vjedhjes ka prere trungje në pyllin publik dhe sasia e druve të prere e kalon 5 meter kub në atë mënyrë që ditën kritike roja e pyllit dëshmitari M. Zh., e ka hasur të pandehurin duke prere dru me motor sharr dhe atë të llojit bung, qarr dhe shkoze në sasi prej 121 cope, të gjata 8-9metra, me diametër 14-32cm, vëllim të përgjithshëm 6.52m³, në pronë publike dhe pa lejen e organit kompetent, me çka të dëmtuarës Komuna e P.-Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural i ka shkaktuar dëm material.

-Me çka i pandehuri ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 17, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe nenit 349 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 242,364, 365, 368, 369, 449, 452 dhe 462 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

I. Me dënim me gjobë në shumë prej **300.00 (treqind) euro** i cili dënim do të ekzekutohet në afatin prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, si dhe **dënim me burgim të kushtëzuar** në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës verifikuese prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale.

II .Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë brenda afatit të përshkruar më lartë, atëherë dënimi me gjobë do t' i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20,00 € të dënimit me gjobë do t' u caktohet 1 (një) ditë burgim.

III . Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

IV . E dëmtuara Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural nga P. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.2286/2024 të datës 12.06.2024, kundër të akzuarit B. H., për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 26.06.2024, gjatë të cilës prezantuan Prokurori i Shtetit Ardiana Veseli nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, përfaqësuesi i palës së dëmtuar M. Zh. dhe i pandehuri.

I pandehuri B. H., pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit deklaroi: Se e pranojë fajësinë, drunjti i kam prerë për nevoja të familjes sepse jam i pa punësuar dhe baba i katër fëmijëve, nuk kam pasur mundësi për të i blerë, e lus gjykatën për një dënim sa më të lehtë sepse çfarëdo dënimi do të ma rëndonte gjendjen ekonomike , ndihmën sociale ma kanë ndalur sepse vajza i ka bërë pesë vite, i premtoj gjykatës se më nuk do ta përsërisë veprën.

Prokurori i Shtetit Ardiana Veseli lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri deklaroi: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sepse i njëjti është bërë me vullnetin e plotë nga i pandehuri dhe bazuar ne shkresat e lëndës.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban Aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit, dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimi të fajësisë nga i akuzuari, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.2 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga vet i akuzuari, gjykata vlerëson se në veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushën të gjitha elementet qenësore të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës dhe të njëjtin e shpalli fajtor, andaj i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, jeton në kushte të rënda ekonomike, premtan se më nuk do të kryej veprime të tilla, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 nën par. 2.6 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, për shkak se gjykata nuk ka pasur ndonjë ekspertizë nga ndonjë ekspert i pavarur për vlerësimin e dëmit, andaj mbi këtë bazë është udhëzuar në kontest civil, pasi që gjykata nuk ja fali besimin, vlerësimin e dëmit vetëm nga pala e dëmtuar për shkak se nuk paraqet bazë të sigurt për gjykim.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.196/2024 me dt.26.06.2024

Sekretare juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj Gjykate.